




REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 14.01.2020, Nr. 09-111-2249



Në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr. 10/2018 të dt. 13/07/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Drejtori i Drejtoratit për Arsim, shpallë këtë:

KONKURS

1. SHFMU „Bajram Curri ” në Nekoc.
 - Një mësimdhënës për arsim fillor, më afat të pacaktuar.
2. SHFMU „ Halil Bajraktari ” – Drenas II
 - Një mësimdhënëse mbështetëse, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit të lehonisë.

KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për të gjitha vendet e punës kërkohet përgatitje adekuate profesionale (me fakultete përkatëse), sipas U.A.10 / 2018.

P.S: Të gjithë kandidatet të cilët nuk janë me përgatitje adekuate, sipas udhëzimit administrativ të lartcekur, përjashtimisht në mungesë të kandidateve me kualifikim përkatës do të shqyrtohen aplikacionet me kualifikim më të përafërt.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, patentë shofer ose pasaportë)
3. Diploma origjinale, ose Çertifikatën origjinale e diplomimit- jo më të vjetër së gjashtë muaj, e vërtetuar ne Komunë - Noteri publik.
4. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më të vjetër së gjashtë muaj.
5. Vërtetim i përvojës së punës vetëm ne arsim.
6. Çertifikatë mjekësore për gjendjen shëndetësore lidhur me çështjen e punësimit, për kandidatët që pranohen në punë.
7. Kopje të Çertifikatave të trajnimeve përkatëse (nëse keni)

REKRUTIMI:

Intervistat me shkrim dhe me gojë dhe përzgjedhjen e kandidatëve do të bëj Komisioni i përzgjedhur nga DKA.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurrim merret në zyrat e DKA-së, të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurimit dhe dokumentet shtesë jashtë dorëzimit në arkiv nuk pranohen. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Drenas,
Më:14.01.2020

Drejtori i DKA-së
[Signature]
Hamet Gjoka